



Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), në përputhje me nenin 28, nenin 34, paragrafi 3, pika a) nën-pika 1) të Statutit të Federatës së Futbollit të Kosovës, nenin 10, të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Federatës së Futbollit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 02.03.2022 pas votimit unanim të të pranishmëve bie këtë:

V E N D I M

- I. Kuvendi i rregullt zgjedhor për Kryetar të Federatës së Futbollit të Kosovës mbahet me datë 06 prill 2022.**
- II. Obligohet Sekretariati Gjeneral i FFK që t'i njoftoj delegatët për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të rregullt zgjedhor 30 ditë përpara.**
- III. Vendi dhe koha e mbajtjes së Kuvendit të rregullt zgjedhor për Kryetar të FFK-së do të precizohet dhe do t'iu kumtohet delegatëve së paku 10 ditë para datës së mbledhjes së Kuvendit Zgjedhor.**

A r s y e t i m

Komiteti Ekzekutiv në mbledhjen e mbajtur me datë 02.03.2022 konstatoi se viti 2022 është vit zgjedhor për zgjedhjen e Kryetarit të FFK-së, ashtu që duke marrë parasysh se mandati i Kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës mbaron me datë 02.07.2022, Komiteti Ekzekutiv shqyrtoi kohën më të përshtatshme për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta për Kryetar të Federatës së Futbollit të Kosovës, në mënyrë që deri në afatin e përfundimit të mandatit të Kryetarit, të jenë të përfunduara të gjitha procedurat për zgjedhjen e Kryetarit të ardhshëm.

Komiteti Ekzekutiv konsultoi agjenden e Federatës së Futbollit të Kosovës prej datës së mbledhjes së mbajtur të Komitetit Ekzekutiv e deri në datën 02.07.2022 kur edhe përfundon mandati i Kryetarit të FFK-së, për të gjetur kohën optimale për mbajtjen e Kuvendit të rregullt zgjedhor.

Komiteti Ekzekutiv gjeti se në muajin mars 2022 kombëtarja e Kosovës do të zhvillojë ndeshje me kombëtarët e vendeve të tjera si dhe nuk është kohë e mjaftueshme që të bëhen përgatitjet për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të rregullt zgjedhor në këtë muaj.

Po ashtu Komiteti Ekzekutiv shqyrtoi agjenden edhe për muajin maj dhe qershor 2022. Lidhur me muajin maj 2022, Komiteti Ekzekutiv gjeti se janë të thirrura mbi dhjetë takime dhe evente zyrtare nga UEFA dhe FIFA, në të cilat takime dhe evente zyrtare janë të ftuar të marrin pjesë përfaqësuesit e FFK-së, andaj për shkak të përgatitjeve për pjesëmarrje në këto takime, në këtë muaj nuk është e përshtatshme mbajtja e mbledhjes së Kuvendit të rregullt zgjedhor për Kryetar. Në muajin qershor 2022, janë të caktuara ndeshjet kualifikuese për kombëtarën e Kosovës, ndërsa afati i fundit i përfundimit të mandatit të Kryetarit të FFK-së është fillimi I korrikut 2022. Andaj edhe për këta muaj Komiteti Ekzekutiv gjeti se nuk është kohë e përshtatshme që të mbahet mbledhja e Kuvendit të rregullt zgjedhor për Kryetarin e FFK-së.

Ndërsa lidhur me agjenden në muajin prill 2022 Komiteti Ekzekutiv gjeti se përveç ndeshjeve të BKT-Superligës të Kosovës, nuk ka ndeshje të caktuara për kombëtarën e Kosovës si dhe agjenda e FFK-së është më e lirë në këtë muaj. Komiteti Ekzekutiv gjeti se edhe në vitin e kaluar mbledhja e kuvendit

të rregullt të FFK-së është mbajtuar në muajin prill 2021, sipas vendimit të KE i marrur në mbledhjen e muajit mars 2021. Rrjedhimisht, Komiteti Ekzekutiv gjeti se muaji prill 2022 është muaji më i lirë, kur do të mund të mbaheshin Zgjedhjet e rregullta për Kryetar të FFK-së, andaj edhe u vendos që zgjedhjet të mbahen me datë 06.04.2022.

Komiteti Ekzekutiv me rastin e caktimit të datës për mbajtjen e zgjedhjeve për Kryetar të FFK, është bazuar në nenin 28, nenin 34, paragrafi 3, të Statutit të FFK-së, nenin 10, të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe u bazua po ashtu edhe në praktikën e mëhershme të Kuvendeve të rregullta zgjedhore të FFK-së për zgjedhjen e Kryetarëve të mëhershëm.

Prandaj duke u bazuar në të cekurat si më lart, Komiteti Ekzekutiv vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMITETI EKZEKUTIV I FEDERATËS SË FUTBOLLIT TË KOSOVËS



Agim Ademi, Kryetar: _____

Vjollcë Krasniqi, Anëtare: _____

Bakir Burri, Nënkyetar: _____

Agim Dibrani, Nënkyetar: _____

Pregrad Jovic, Nënkyetar: _____

Xhelal Broja, Anëtar: _____

Mirsad Çollaku, Anëtar: _____

Naser Ajeti, Anëtar: _____

Agim Nura, Anëtar: _____

Ismajl Ajeti, Anëtar: _____